

V E N D I M
Nr.428, datë 26.6.2003

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT NË QYTETIN E KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i ujësjellësit në qytetin e Korçës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Korçës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 600 m² tokë truall, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 420 000 (katërqind e njëzet mijë) lekësh.
 4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 139 000 (njëqind e tridhjetë e nëntë mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2003, miratuar për Bashkinë e Korçës.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 10.7.2003.
 7. Pikat 6, 7 dhe 8 të tabelës, që i bashkëlidhet vendimit nr.473, datë 31.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i ujësjellësit dhe kanalizimeve të qytetit të Korçës”, shfuqizohen.
 8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Prefektura e Qarkut të Korçës dhe Bashkia e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT TË
QYTETIT TË KORÇËS**

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Sip/Tokës m ²	Njësia lekë/m ²	Vlera lekë
1.	Fatmira Demirali Çuçllari	500	700	350 000
2.	Eqerem Bektash Kupe	100	700	70 000
	Shuma	600		420 000